



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL Anr.870/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Zyhdi Haziri, kryesues, Ymer Hoxha dhe Afijete Sada-Gillogjani anëtarë, si dhe me pjesëmarrjen e zyrtarit të lart ligjor Kudret Hasani, duke vendosur përkritazi me apelin e Mirushe Sadikaj kandidate për kuvendin komunal në Istog nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega në Istog, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017 për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 12.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

I. Pranohet si e bazuar apeli i Mirushe Sadikaj kandidate për kuvendin komunal në Istog nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega në Istog, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017 për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017.

II. Urdhërohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) që të rinumëroj vetëm fletëvotimet e kandidatëve për anëtarë të Kuvendit Komunal në Istog nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega në Istog për vendvotimet: 0606C/01R; 0606C/02R; 0606C/05R

III. Rezultati i cili del pas rinumërimit të fletëvotimeve në kutit e Vendvotimet si në pikën - II- të këtij dispozitivi, të përfshihet në rezultatin përfundimtar.

A R S Y E T I M

PZAP-i, ka pranuar një apel më datë 10.11.2017 në ora 10:30 Mirushe Sadikaj kandidate për kuvendin komunal në Istog nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega në Istog në të cilën thekson se vendvotimet 0606C/01R; 0606C/02R; 0606C/05R se ka mungesa të votave. Parashtruesja e apelit kërkon nga PZAP-i që ky apel të pranohet si i bazuar dhe ti urdhërohet KQZ-së që të vërtetojë gjendjen e saktë faktike.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i shqyrtoj pretendimet ankimore dhe materialin zgjedhor dhe pas vlerësimit të gjithanshëm të tyre gjeti se:

apeli është i bazuar

Paneli gjeti se pretendimet ankimore janë të bazuara, pasi që pas shqyrtimit të provave dhe shkresave të lëndës, si dhe nga hetimi i bërë në materialin zgjedhor ka konstatuar se ka

mospërputhje të rezultateve të shpallura nga KQZ-ja me ato për të cilën pretendon pala ankuese, andaj mbi këtë baze dhe në mbështetje të nenit 117.4 të LZP-së, PZAP-i urdhëron KQZ-në që të bëhet rinumërimi i të gjitha fletëvotimeve për anëtarë të Kuvendit Komunal në Istog nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega në Istog për vendvotimet e larcekura, ashtu që rezultati i dal nga ky rinumërim ti bashkëngjitet rezultatit përfundimtar.

Prandaj më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura dhe bazuar në nenet 115.1, dhe nenin 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze*

Nga sa u tha me sipër e ne mbështetje të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
ZL A nr. 870/2017 më datën 12.11.2017.



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.